

VENDIM
Nr. 206, datë 9.4.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 856, DATË 10.12.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT
DIPLOMATIK, PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME, TË PASURISË NR.
1/586/5, ZONA KADASTRALE NR. 8380, TIRANË, PËR T’U PËRDORUR SI SELI E
SEKRETARIATIT TË FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 856, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, të pasurisë nr. 1/586/5, zona kadastrale nr. 8380, Tiranë, për t’u përdorur si seli e Sekretariatit të Fondit të Ballkanit Perëndimor”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për periudhën dhjetor 2014 – dhjetor 2029, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për Ministrinë e Punëve të Jashtme, të pasurisë nr. 1/586/5, zona kadastrale nr. 8380, Tiranë, për t’u përdorur si seli e Sekretariatit të Fondit të Ballkanit Perëndimor.”;

b) në pikën 3, fjalët “... afatit pesëvjeçar ...” zëvendësohen me “... afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi ...”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku